

20 shkurt 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (PG) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB Sigal Prishtina të datës 18.02.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 20.02.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 18.02.2026;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 18.02.2026 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Vendimi me nr. 26/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 17.02.2026.

A R S Y E T I M

Më datë 18.02.2026, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Sigal Prishtina të po të njëjtës datë, si palë e interesuar lidhur me refuzimin e ankesës së KB Sigal Prishtina ndaj ndeshjes së zhvilluar në mes të KB Vëllaznimi dhe KB Sigal Prishtina, të zhvilluar më 14 shkurt 2026 (tash e tutje "Ankesa"). Ankesa bëhet ndaj Vendimit me nr. 26/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 17.02.2026, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me refuzimin e Ankesës së KB Sigal Prishtina ndaj ndeshjes në fjalë.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 20.02.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Sigal Prishtina, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga KB Sigal Prishtina. Gjatë vlerësimit të lëndës, përveç rregullativës së brendshme të FBK, KAA gjithashtu ka analizuar me vëmendje edhe video inqizimin e ngjarjes dhe provat e tjera të ndërlydhura.

Sipas kuptimit të KAA, KB Sigal Prishtina sfidon Vendimin e KG të identifikuar më sipër duke aluduar ndër të tjera se ndeshja e datës 14 shkurt 2026 është dashur të regjistrohej me rezultatin 20-00 në favor të KB Sigal Prishtina për shkak të sulmit fizik që ka ndodhur ndaj njërit nga gjyqtarëve të ndeshjes në fjalë. KB Sigal Prishtina argumenton ndër të tjera se Vendimi i KG i ka cenuar të drejtën për trajtim të barabartë, ka bërë interpretim të gabuar dhe formalist të Nenit 41.7.6, dhe se

përbën gabim në vlerësim procedural. Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA “I. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 26/2025-26; II. Konstatimin e zbatimit jo të barabartë të rregullores; III. Rishqyrtimin e plotë të rastit në përputhje me parimet e proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së integritetit të garës; IV. Marrjen e një vendimi të ri që reflekton përgjegjësinë reale të klubit për incidentin.”

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Sigal Prishtina ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të KG. Njëheri, KB Sigal Prishtina ka paguar edhe taksën obligative për parashtrim të ankesës. Rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim

KG në Vendimin e tij, Pika II e dispozitivit, “HEDH POSHTË ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 15.02.2026 si të papranueshme”. Për të arsyetuar këtë qëndrim, KG citon në Vendimin e vet Nenin 44.1 të PG. KAA vën re se KG me të drejtë bazohet në 44.1 për të shqyrtuar lejueshmërinë e parashtrimit të ankesës nga KB Sigal Prishtina. Pra, lejueshmëria për të parashtruar ankesë ndaj një ndeshjeje gjendet në Nenin 44.1 të PG. Neni 44.1 i PG thotë:

44.1. Konform Rregullave Zyrtare të lojës së basketbollit, ankesë mund të paraqes ekipi i cili mendon se është dëmtuar nga:

44.1.1. një gabim në udhëheqjen e procesverbalit të ndeshjes (DSS), matjes së kohës ose matjes së kohës së sulmit, të cilin gjyqtarët ishin të autorizuar ta korrigjonin sipas rregullave zyrtare të basketbollit dhe kishin qasje në prova të verifikueshme në momentin e marrjes së vendimit për ta korrigjuar gabimin, por nuk e bënë këtë;

44.1.2. një vendim për të humbur ndeshjen e pa-zhvilluar, për të anuluar, për të shtyrë, për të mos rifilluar ose për të mos luajtur ndeshjen;

44.1.3. paraqitja e lojtarit i cili nuk është regjistruar sipas Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve, apo me paraqitjen e lojtarit të dënuar.

Duke analizuar tekstin e Nenit 44.1, është më se e qartë se ankesa e KB Sigal Prishtina ndaj ndeshjes, ashtu si e parashtruar, nuk bie në një rën nga kategoritë e parapara në paragrafët 1 deri 3 të cituara më sipër. Prandaj, ka qenë e pamundur për KG që të lëshohet në vlerësim meritore të ankesës në fjalë, pasi që ankesa si e tillë ka qenë e palejuar sipas Nenit 44.1. Për këtë arsye, edhe KAA ka vendosë që të refuzojë ankesën e KB Sigal Prishtina dhe të vërtetojë Vendimin e KG të sfiduar nga KB Sigal Prishtina.

Thënë atë, KAA e gjen të arsyeshme të potencojë se pjesa e dytë e Vendimit të KG ka qenë e panevojshme. Për më të tepër, KAA vlerëson si arbitrar përkufizimin e “sulmit fizik” të bërë nga KG përkitazi me Nenin 41.7.6 të PG, ku parashihet ndërprerja e menjëhershme e ndeshjes në rast të sulmit fizik ndaj personave zyrtarë.

Deri sa PG nuk parashihet ndonjë përkufizim të “sulmit fizik”, me analogji mund të konsultohet Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, ku në Nenin 184 jepet përkufizimi i “sulmit” si “[k]ushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër.” Me kaq konsumohet sulmi! Nga video inqizimi i ngjarjes shihet qartë se vlerësimet e KG se “[k]a pasur tentim për kontakt fizik me gjyqtarin” dhe se “[n]uk është realizuar sulm fizik në kuptimin e përmbushjes së elementit material të goditjes apo shkakut të lëndimit trupor” janë të pasakta. Video inqizimi tregon qartë se gjyqtari në fjalë ka pësuar sulm fizik (pra nuk ka qenë tentim) duke u goditur nga mbrapa, dhe KAA nuk pajtohet me KG se element material i “sulmit fizik” është doemos edhe shkaktimi i lëndimit trupor.

Video inqizimi gjithashtu tregon qartë dështimin eklatant të organizatorit të ndeshjes për të ofruar siguri të duhur për pjesëmarrësit në këtë ndeshje, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarin që ka qenë cak i sulmit fizik.

Në raste të tilla të sulmit fizik ndaj gjyqtarit, Neni 41.7.6 është shumë strikt, ashtu që obligon ndërprerjen e menjëhershme të ndeshjes dhe regjistrimin e lojës me rezultat zyrtar. Mirëpo, KAA vlerëson se në bazë të Nenit 41.6 të PG, gjyqtari ka qenë përgjegjës për dhënien e vlerësimit nëse duhej zbatuar neni 41.7.6 apo jo në atë moment. Mbetet për organin kompetent që vlerëson performancën e gjyqtarëve të përcaktojë nëse zbatimi i PG dhe i Nenit në 41.7.6 nga gjyqtari në fjalë është bërë në mënyrë të duhur.

Prandaj, KAA, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 20 shkurt 2026



Vendimi i dërgohet:

- KB Sigal Prishtina
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.